

Rezolute Drejtuar:

Parlamentit Shqiptare
K/Ministrit te Shqiperise
Ministrit Mjedisit
Bankes Boterore

Lenda : Kerkese per ndryshimin e ligjit te Pyjeve Nr 9385 date 04/05/2005 " Per Pyjet dhe Sherbimin Pyjor" ne Shqiperi;

(Rreth 60 % e tokes se Shqiperise administrohen me ligje komuniste- 15 vjet pas shpalljes se pluralizmit- Rezultati pjesa me e madhe e pyjeve te vendit eshte prere, djegur e shkaterruar)

Ne Shqiperi pas viteve 1990 krahas ndryshimeve pozitive ne fushat e ndryshme ekonomike e sociale reflektuan edhe mangesi vecanerisht ne drejtim te Pyjeve e mjedisit dhe kryesisht demtimi i pyjeve qe administrohen nga Shteti (perfshire edhe Zonat e Mbrojtura dhe Parqet)

Ne mendojme se shkaqet kryesore per mangesi ne zhvillimin e ketij sektori jane te shumte por disa prej tyre ne mendojme se jane me te rendesishem;

- Nga pervoja e demokracive Europiane shteti demokratik nuk eshte pronar dhe menaxher, asetet e tij u delegohen etniteteve dhe marredheniet me ta rregullohen me ligje e kontrata
- Shteti yne eshte pronar i pyjeve dhe kullotave
- Shteti yne harton ligje per pronat e tij (pronari harton ligjin sipas interesave te tij)
- Administrata e pyjeve emertohet nga shteti, dhe nuk zbaton ligjin por urdherat qe merr nga pronari, dhe ne konjuktura te vecanta e shkel ligjin
- Shteti si hartues i ligjit eshte dhe shfrytezues i ketyre pasurive-askush nuk e kontrollon
- Ligji mbi Pyjet eshte nje ligj qe me gjithë permiresimet e bera nuk per afrohet me ligjet e vendeve te zhvilluara .
- Ne ligj nuk percaktohet qartazi si do te jete pronesia e Pyjeve per pasoje nuk jane te ndara edhe pergjegjesite per te gjithë pronaret dhe perdoruesit.
- Ajo qe eshte me e rendesishme se ne ligj vetem nje strukture qe eshte DPSHP realizon edhe politikat e zhvillimit menaxhimin dhe kontrollin e zbatimit te ligjit. Nderkohe qe eshte pronare e Pyjeve ?
- Mbajtja e kompetencave dhe pergjegjesive nga strukturat ne nivel qendror le hapësira per te penguar menaxhimin dhe pergjegjesine ne nivel vendor.
- Edhe pse Pyjet e Kullotat jane transferuar ne Perdorim Komunal akoma kuadrot mbahen e paguhen nga DPSHP (shteti) dhe te gjitha kompetencat mbahen gjithashtu nga pushteti qendror dhe deri tani asnje mbeshtetje nuk jepet jo vetem me mbeshtetje financiare por as edhe teknike e Keshilluese.

Nga pervoja qe kemi marre ne vendet Europiane parimi i organizimit te Pyjeve eshte pothuajse unik: popullatat lokale (komunat e bashkite) marrin aq pyje dhe kullota qe mund ti arrijne per te siguruar nevojat e tyre, pjesen qe nuk e arrijne ata, zonat e mbrojtura si dhe trashëgimi te tjera te ndryshme i mban shteti.

Ketu ka dy probleme:

Se pari: Prerja per nevojat vjetore te zonave rurale per dru zjarri ne Shqiperi sipas nje studimi te kryer nga nje kompani konsulence nderkombetare e mbeshtetur nga Banka Boterore eshte 2 milion m3, ndersa duke perfshire edhe aktivitetet e tjera eshte 2.7 milion m3 ne vit, nga 864 mije m3 qe eshte mundesia vjetore e shfrytezimit. (Skema ne fund). Pra 74 % e prerjeve totale shkon per nevojat e fshatit. Prej ketyre shteti (DPSHP) shet mesatarisht rreth 200 mije m3 ne vit, pra ka nen kontroll me pak se 10% te aktivitetit.

Konkluzioni qe terhiqet ne kete kendveshtrim: zonave rurale u duhet te perdorin per te siguruar nevojat e tyre per ngrohje mbi dyfishin e asaj qe ofron teresia e pyjeve te Shqiperise. Pra komuniteteve lokale u duhet transferuar e gjithë siperfaqja e pyjeve. Përveç kesaj per te shtuar mundesine e prodhimit dhe ekuilibret e ekosistemit, duhet qe me cdo kusht te ndiqet politika ekonomike qe per disa vite te importohen drute e zjarrit. (Ne Kosove ka tre vjet qe shteti mbeshtet importin e druve te zjarrit).

Ne kete gjendje jane katandisur ekosistemet pyjore.

Shqiperia humbet per cdo vit 60 milion m3 toke nga erozioni, shkaterrohen rruge permbyten shtepi banimi, fusha mbushen rezervuaret e hidrocentraleve.

Se dyti: Nese shteti nuk e merr ne konsiderate kete argument: por per arsye te ndryshme kerkon te mbaje nje pjese te territorit te vendit ne pronesi te tij, ne kushtet dhe nevojat e komuniteteve lokale kjo nuk mund te jete me shume se 15-20%, dhe ne asnje menyre nuk mund te menaxhohet po nga shteti. Shteti mund te jete aksioner ne nje koorporate SHA ?? si te jete me mire.

Pas kesaj mund te llogjikohet per hartimin e ligjit te pyjeve, qe si koorporates si shtetit, ashtu edhe komunitetet vihen ne te njejtin plan dhe kane paraligjitt te njejtat detyrime. Komunitetet, pronaret private te pyjeve dhe nese edhe koorporata jane menaxher dhe te barabarte paraligjitt, zbatimin e te cilit e kontrollojnë shteti.

Aktualisht ne te gjitha nivelet per pyjet Komunal jane krijuar struktura menaxhuese. Fshati komisionin e kujdesimit per pyjet e tij, ne nivel komune u krijuan edhe Shoqatat me vone u krijuan edhe struktura ne nivel qarku (Federatat e Pyjeve komunal ne Qarkun Kukës Korce dhe Diber dhe ne vitin 2005 u krijuan edhe nje shoqate ne nivel Kombetar).

Keto struktura jane bashkime vullnetare te shume shoqatave e qytetareve te interesuar per te permiresuar qeverisjen e Pyjeve ne Shqiperi.

Ka tre vjet qe asnjeri nuk kujdeset per pyjet dhe kullotat e transferuara ne perdorim privat e Komunal pervec shoqatave, komunave e Federatave dhe i ndonje organizates te huaj si SNV (**Organizata Hollandeze per Zhvillim Shqiperi**), **SIDA**, **Partneret Shqiperi**, **Soros** qe mbeshtetin kryesisht me asistencë teknike per rritje kapacitetesh e permisim te qeverisjes vendore.

Per te patur sukses ne menaxhimin e qendrueshem te pyjeve ne mendojme se eshte shume e rendesisheme rishikimi i Ligjit te Pyjeve.

Aktet N/ ligjore qe shteti duhet te nxjerre te pershtaten ne favor te zhvillimit dhe qeverisjes me te mire te Pyjeve duke realizuar dhenien e pergjegjesive aktoreve lokal. Aktoret lokale duhet te jene pjese ne hartimin e ketyre akteve dhe mos te lihen vetem ne doren e DPSHP-se te cilet ne kete rast paraqesin konflikte interesi.

Ne mendojme se per te vazhduar procesin e ketyre ndryshimeve duhet marre ne konsiderate eksperienca pozitive e vendeve te zhvilluara si Austria, Gjermania, Holanda, Zvicra. Perfagesues nga institucionet tona por edhe nga Shoqatat kane bere vizita studimore per te pare nga afer dhe

marre informacion mbi hapesirat ligjore, pronesine e tokes pyjore, strukturat per te gjitha pronesite e Pyjeve si menaxhohen pyjet dhe si mbrohen ato .

Sejcili pronar dhe perdorues te kete strukturat e veta dhe ne nivel Qendror te kete struktura te vecanta qe bejne Politikat dhe struktura te ndara qe bejne kontrollin e zbatimit te ligjit.

Ne do te japim kontributin dhe mbeshtetjen tone per te vazhduar procesin e reformave ne rruget e zhvillimit te qendrueshem duke e konsideruar mjedisin natyror si pjesen me te rendesishme te ketij zhvillimi.

-Ne besojme qe argumentat e mesiperme jane te mjaftueshme per te ndryshuar ligjin e Pyjeve dhe per ta shendruar ate ne shembull te nje qeverisje te mire te pyjeve, shtys per procesin e decentralizimit dhe nje mundesi me shume per tu integruar ne BE.

Pergatitur nga :

Federatat e Pyjeve e Kullotave Komunal te Qarkut Diber, Korce, Kukes dhe Federata Kombetare

47 Shoqata Perdoruesish Pyjesh dhe Kullotash komunal te Qarkut Diber, Korce dhe Kukes qe kane ne perdorim mbi 300 mije Ha Pyje.

